



Prishtinë: 02.09.2021  
Kodi i ZRRE-së: V\_1391\_2021

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2181\_05\_21**;
- Ankesën e konsumatorit të dt. 05.07.2021;

në seancën e mbajtur më datë 02.09.2021 lëshon këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit S.B nga Komuna e Podujevës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2181\_05\_21, i datës 28.05.2021.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve me datë 28.05.2021 ka marrë vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2181\_05\_21 me të cilin e ka ZRrE është shpallur jokompetente për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës së konsumatorit Selman Bejtullahu, për shkak të ngarkesës nga ana e KESCO-s me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthim të humbjeve).

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori S.B brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së për këto shkaqe:

- Konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe
- Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Me datë 26.10.2013 punëtorët e autorizuar të KEDS-it e kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë konstatuar se në momentin e kontrollës është potencuar se janë kontrolluar hyrjet dhe daljet e njehsorit dhe kabli furnizues është anashkaluar dhe furnizion pajisjet e evidentuara në procesverbal. Konsumatori duhet të parashtrorë kërkesë për Pëlqim Elektroenergetik pasi që tejkalohej fuqia 15 kW, si dhe është eliminuar kabli i furnizimit i cili e ka anashkaluar njehsorin.



Me datë 31.10.2013 Departamenti i Faturimit e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesën e rikthimit të humbjeve DPR13HP12311 në vlerë financiare prej 6,263.00 EUR. Më pas konsumatori parashtron ankesë në KESCO dhe me datë 19.11.2013 KESCO i përgjigjet konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij.

Konsumatori S.B, pas këshillës juridike nga Përgjigja e KESCO-s, ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Podujevë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, kundër të paditurës KEDS Sh.A., me bazë të kontestit pasurim i pa bazë dhe shlyerje e borxhit.

Gjykata Themelore në Podujevë, me datë 15.04.2021 ka lëshuar Aktvendimin me numër C.nr.117/2021, me të cilin e ka hedhur poshtë padinë si të pa lejuar, me arsyetimin se objekti i kësaj lënde është me natyrë administrative dhe kompetente për zgjidhjen e këtij kontesti është Zyra e Rregullatorit për Energji.

Pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, administrimit të provave veç e veç, Bordi i ZRrE-së konstaton se:

- Shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike (rikthimi i humbjeve) është veprë penale sipas kapitullit XXVI të Kodit Penal të Kosovës, si dhe sipas Ligjit Nr.05/L – 085 për Energji Elektrike. Në këtë kuptim, është në kompetencë të organeve të drejtësisë që të procedojnë më tutje me këtë rast dhe rrjedhimisht, lëndët për shfrytëzim të pa autorizuar të energjisë elektrike apo shprehur sipas Kodit Penal vjedhja e energjisë elektrike ka elemente të veprës penale, dhe nuk ka më karakter administrativ. Gjithashtu, edhe sipas nenit 4 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, **ZRrE nuk ka mandat ligjor** që të shqyrtoj ankesat që kanë elemente të veprës penale të vjedhjes së energjisë elektrike, pasi që, siç u potencua edhe më lartë, është në kompetencë të organeve të drejtësisë.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ymer Fejzullahu, Kryesues

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

---

Lutfije Dervishi, anëtare

---

Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-së,
- Konsumatorit S.B dhe
- Arkivit të ZRRE-së.